



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:141875

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05772437

KPPP.nr.479/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit TEB Sh.A me seli në Prishtinë, rr. “Agim Ramadani” nr. 15, që sipas autorizimit përfaqësohet nga Debt Collection Agency L.L.C me zyre në Prishtinë, kundër debitorëve 1. “DO RE MI” SH.P.K., me nr. të biznesit 70447231 dhe me seli në Lipjan, si dhe 2. M.Z. me adresë në rr. “...” nr. ..., Prishtinë, që sipas autorizimit përfaqësohen nga avokate Vahide Braha nga Prishtina, duke vendosur sipas propësimi të debitorëve të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 258/18 të datës 12.11.2018, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Jeton Krasniqi me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seance, me datë 03.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si i pabazuar propësimi i debitorëve 1. “DO RE MI” SH.P.K. dhe 2. M.Z. i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 258/18 të datës 12.11.2018, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Jeton Krasniqi.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr. 258/18 i datës 12.11.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Jeton Krasniqi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit TEB Sh.A me datë 12.11.2018 ka lëshuar Urdhrin përmbartimor P.nr. 258/18 me të cilin ka lejuar përmbartimin kundër debitorëve 1. “DO RE MI” SH.P.K., me nr. të biznesit dhe 2. M.Z., dhe atë në bazë të dokumentit Marrëveshjen mbi pengun e datës 29.06.2011 marrëveshje kjo e regjistruar në regjistrin e pengut

sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20180921-278 e datës 21.09.2018, për pagesën e borxhit në shumë prej 11,901.40 EUR si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërësi Urdhrin për lejimin e përbarimit me arsyetimin se kërkesa që buron nga dokumenti përbarimor është përfshirë në parashkrim, kjo sepse ka kaluar afati prej 5 viteve nga neni 352 i LMD-së për realizimin e borxhit nga dita e lidhjes së marrëveshjes së kredisë më 23.06.2010. Me kërkesë që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorëve si të bazuar dhe të shfuqizohet urdhri për lejimin e përbarimit.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit me arsyetimin se nuk qëndron fakti se borxhi është përfshirë në parashkrim, kjo pasi që afati i parashkrimit do mund të llogaritej pas kalimit të afatit për pagesë të këstit të fundit, dhe se afati i parashkrimit fillon të rrjedh vetëm nëse kreditori nuk ndërmer asnjë veprim me qëllim të realizimit të kërkesës, çka nuk rezulton të jetë në rastin konkret. Me kërkesë që Prapësimi të refuzohet dhe Urdhri Përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore përcaktohet se dokument përbarues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*. Ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Gjykata duke vlerësuar Marrëveshjen mbi pengun e datës 29.06.2011, është hartuar në formën e paraparë me ligj dhe përmban të gjitha elementet nga neni 27 par.1 i LPP-së e po ashtu është regjistruar në regjistrin e pengut, fakt ky që vërtetohet nga konfirmimi mbi regjistrimit e pengut me R-20180921-278 e datës 21.09.2018, dhe i është bashkangjitur propozimit për përbarim në

kopje të vërtetuar, dhe si e tillë përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 22 par.1.7 a të LPP-së për të qenë të pambarueshëm dhe njëkohësisht të përshtatshëm për përmbarim.

Pretendimet e debitorëve se borxhi që derivon nga dokumenti përmbarimor është përfshirë në parashkrim pasi që nga data e lidhjes së marrëveshjes së kredisë më 23.06.2010 e deri në inicimin e procedurës përmbarimore kanë kaluar mbi pesë (5) vite gjykata e vlerësoi si të paqëndrueshëm kjo pasi që në rastin konkret, kërkesa nga marrëveshja mbi kredinë e datës 21.12.2010 është e siguruar me peng, andaj në mbështetje të nenit 349 të LMD-së i cili parasheh se *“Kur të ketë kaluar afati i parashkrimit, kreditori kërkesa e të cilit është e siguruar me peng ose me hipotekë, mund të paguhet vetëm nga sendi i ngarkuar, në qoftë se e mban në dorë apo në qoftë se e drejta e tij është regjistruar në regjistrat publikë”*, rezulton se kreditori, ka të drejtën që ta realizoj kërkesën e tij të parashkruar vetëm nga sendi i ngarkuar, në këtë rast nga sendi i lënë peng.

Në shqyrtimin e pretendimeve tjera të debitorit, gjykata konstaton se i njëjti nuk e ka bërë të besueshëm prapësimin me prova konkrete si dhe nuk i ka përmbarur asnjërën nga kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 71 lidhur me nenin 69.4 të LPP-së, andaj gjykata vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore për anulimin e urdhri për lejimin e përmbarimit.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 479/22, dt. 03.06.2024

G j y q t a r i

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej (7) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.